

VENDIM
Nr. 9, datë 5.2.2020

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARISË FINANCIARE SHITESË NGA BANKA TIRANA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 204, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 18, pika 8, të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, të ndryshuar; të pikës 6, të shtojcës 1, të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 36, datë 26.5.2010, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Tirana sh.a. të veprimtarisë financiare shitesë të ndërmjetësimit në sigurime, në rolin e brokerit.
 2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Banka Tirana sh.a., pas paraqitjes së licencës së dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko